



Nr. Ref. BD-220/51

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 12083 m² pjesë e parcelës kadastrale 00807-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 17169 m², ZK Ujlar, komuna Graçanicë, pronë e KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesë ka theksuar se pjesën e ngastrës e cila është objekt i kërkesës e ka në shfrytëzim pasi që është edhe pronarë i ngastrave 803-1 dhe 803-2 të cilat janë afër ngastrës në fjalë, dhe se mbi këtë ngastër kalojnë telat e lartëpërquesit dhe si e tillë kjo mund të shfrytëzohet vetëm për bujqësi dhe jo diçka tjetër. Në këtë ngastër kadastrale nuk ka ndërtime dhe e njëjta ka qasje në rrugë fushore gjë që e njëjta është përshkruar edhe në ekspertizën gjeodezike përmes ortofotove dhe skicës të dorëzuar nga vet parashtruesi i kërkesës. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e kësaj ngastre kadastrale pasi të njëjtën e kanë në shfrytëzim nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Në ngastër nuk ka ndërtime dhe e njëjta ka qasje në rrugë, elemente këto që përjashtojnë shitjen përmes shitjes direkte. Po ashtu kjo ngastër është edhe nën komasacion.


AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lart Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.


Menfor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/52

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00365-0 me sipërfaqe të përgjithshme 24437 m², ZK Suhodoll, komuna Graçanicë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KB Kosova, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, këtë pronë e ka në shfrytëzim qysh prej periudhës së pasluftës së bashku me anëtarët e familjes së tij, të cilën e shfrytëzon për nevoja bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim apo të mbjella pemë dhe prona ka qasje të pa penguar në rrugë. Këtë faktë e ka deklaruar edhe vetë ekspertiza gjeodezike e dorëzuar nga pala dhe se pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues i parcelës nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Po ashtu kjo ngastër është edhe nën komasacion.


AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke pas parasysh gjitha ato që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/53

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 4308-0 me sipërfaqe të përgjithshme 3294 m², ZK Jashtë Qytet, komuna Gjakovë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Ereniku, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Ereniku, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka theksuar se këtë ngastër e shfrytëzon që nga koha e paralufitës dhe se e njëjta i nevojitet për zhvillimin e biznesit familjar. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike nuk ka ndërtim. Pretendimi i palës se i njëti ka shprehur gadishmërin për blerjen e kësaj ngastre kadastrale pasi të njëjtën e kanë në shfrytëzim dhe se e njëjta i nevojitet për zhvillimin e biznesit familjar nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Nuk është kontestuese se parashtruesi i kërkesës ka parcela të tij private në kufi me ngastrën e cila është objekt i kërkesës mirëpo në kufi të saj janë edhe ngastra të tjera private ashtu sikurse janë përshkruar në ekspertizën gjeodezike, gjegjësisht ngastra është e rrethuar me prona të ndryshme private të cila potencialisht mund të kenë interesim për këtë ngastër. Po ashtu lidhur me këtë ngastër ka parashtruar kërkesë edhe që është familjar i parashtruesit të kërkesës në këtë raste. Po ashtu kjo ngastër është edhe nën komasacion.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024. Duke u bazuar në këto që u cekën me lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/54

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 4308-0 me sipërfaqe të përgjithshme 3294 m², ZK Jashtë Qytet. komuna Gjakovë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Ereniku, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Ereniku, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka theksuar se këtë ngastër e shfrytëzon për bletari dhe se kjo ngastër është në kufi me ngastrat e tij. Në këtë parcelë aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike nuk ka ndërtim. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gadishmërin për blerjen e kësaj ngastrë kadastrale pasi të njëjtën e kanë në shfrytëzim dhe se e njëjta i nevojitet për bletari nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Nuk është kontestuese se parashtruesi i kërkesës ka parcela të familjareve të tij në kufi me ngastrën e cila është objekt i kërkesës mirëpo ne kufi të saj janë edhe ngastra të tjera private, gjegjësisht ngastra është e rrethuar me prona të ndryshme private të cilët potencialisht mund të kenë interesim për këtë ngastër. Ajo çka duhet theksuar këtu është se lidhur me këtë ngastër ka parashtruar kërkesë edhe Skënder Kamberi që është familjar i parashtruesit të kërkesës. Po ashtu kjo ngastër është edhe nën komasacion.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në këto që u cekën me lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/55

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme 27729 m², ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e tij e ka arsyetuar me faktin se ngastra gjendet përpara ngastrave të babait të tij dhe si rrjedhojë kërkon një pjese të kësaj ngastre (pa specifikuar saktë cilën pjesë) ta privatizoj në drejtim të parcelave të tij dhe rrjedhimisht pala theksuar se dëshiron ti mbjellë me fidanë dhe pemë të ndryshme. Prona sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit ka qasje nëpër rrugë, në fakt rruga e emëruar Anton Qeta kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës dhe se AKP-ja ka disa kërkesa të personave fizik lidhur me pjese të kësaj ngastre. Pretendimi i palës se i njëjta është dëshiron ti blejë këto ngastra për faktin se kjo ngastër gjendet përpara ngastrave të babait të tij dhe se dëshiron ti mbjellë me fidanë dhe pemë të ndryshme nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/56

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes prej 2590 m², pjesë e parcelës kadastrale 00442-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 39697 m² dhe të sipërfaqes prej 2156 m² pjesë e parcelës kadastrale 00448-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 65451 m² ZK Drobesh, komuna Viti, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava në Viti, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava në Viti, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore. Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesën e vet ka theksuar se është duke i shfrytëzuar këto pjesë të sipërfaqeve që nga viti 2000 për kullos dhe arë. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gadishmërin për blerjen e këtyre pjesëve të ngastrave sepse është duke i shfrytëzuar nga viti 2000 për kullos nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte. Po ashtu, arsye tjetër është fakti se prona ka qasje direkte në rrugë dhe nuk ka ndërtim. Po ashtu kjo ngastër është edhe nën komasacion.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/57

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00280-2 me sipërfaqe të përgjithshme 149471.2 m² dhe parcelës kadastrale 00286-0 me sipërfaqe të përgjithshme 113061.5 m², ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesën e vet ka theksuar se Famullia “e Shën Jozefit” në këtë ngastër para 40 viteve u ndërtua “Udha e Kryqit” që në komunitetin katolik dhe famullinë, ka një rendësi të veçantë shpirtërore dhe morale, përderisa ngastra 2886-0 nevojitet për varrezat e fshatit. Parcelat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës gjenden në zonën kadastrale Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe blegtorale të njëjtat kanë sipërfaqe të madhe prej 16 Ha e cila është një sipërfaqe e konsiderueshme për nga madhësia e tyre. Në këto parcela sipas ortofotos - pamjeve të gjeoportalit kanë qasje nëpër rrugën Muzeu dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo pala nuk ka përmendur në kërkesë se të njëjtat janë në posedim apo shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës.

Po ashtu pretendimi i palës se e njëjta dëshiron ti blej këto ngastra për faktin se në këtë ngastër para 40 viteve u ndërtua “Udha e Kryqit” që në komunitetin katolik dhe famullinë, ka një rendësi të veçantë shpirtërore dhe morale, përderisa ngastra 2886-0 nevojitet për varrezat e fshatit nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/58

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P.Nr. 691-1 me sipërfaqe të përgjithshme 14301 m², ZK Lubizhdë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesën e vet ka theksuar se këtë pronë e ka në shfrytëzim qysh pas luftës dhe të njejten e ka në shfrytëzim edhe aktualisht si tokë bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe prona ka qasje të pa penguar në rrugë. Pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues i parcelës nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/59

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të ngastrës kadastrale P. Nr.0404-0 me sipërfaqe të përgjithshme 8842 m² ZK Trepetincë, komuna Suharekë pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Progres", Prizren, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Progres", Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, këtë pronë e ka në shfrytëzim qysh prej vitit 2000 dhe të njëjtën e ka në shfrytëzim edhe tani si tokë bujqësore, në të cilën sipas deklaramit të tijë ka të ndërtnuar një objekt të pa përfunduar për të mbajtur veglat bujqësore për punimin e patundshmërisë. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtnim dhe prona ka qasje të pa penguar në rrugë publike. Po ashtu në ortofoton e vitit 2018 nuk shihen gjurmë të ndonjë objekti, për të cilën pala ka deklaruar se ka filluar të ndërtojë për nevoja të pajisjeve bujqësore. Pretendimi i palës se i njëjti dëshiron të privatizojë këtë parcelë përmes shitjes direkte pasi që të njëjtën e ka në shfrytëzim nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/60

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale:

- P-71813023-00607-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4657 m², ZK Atmaxhë, Prizren
 - P-71813023-00712-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 12677 m², ZK Dushanovë, Prizren
- Në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, Prizren, me parashtruesin

I. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI "Progres", Prizren, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, këto ngastra kadastrale është duke i shfrytëzuar që nga vitet e 60-ta për çka deklaroi se ka të lidhur dhe kontratë shitblerjeje. Sa i përket kërkesës për ngastrën kadastrale 712-0 parashtruesi deklaroi se të njëjtën e ka në shfrytëzim për nevoja bujqësore për të cilën e ka blerë prindit të tij dhe ka lidhur kontratë interne e që emri i shitësit nuk i kujtohet dhe se kontratën për të njëjtën nuk e posedon për shkak rrethanave të ndodhura në Kosovë. Ndërsa në anën tjetër lidhur me ngastrën 607-0 ndër të tjera në kërkesën e parashtruar i njëjti thekson se ngastrën e ka blerë gjyshi i tij ku përmend kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmerisë me shenjen Leg.nr.755/62 të dt. 19.06.1962 megjithatë nuk i ka bashkangjitur të njëjtat me kërkesën. Po ashtu në këto parcela aktualisht nuk ka ndërtim dhe pronat kanë qasje në rrugë. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e këtyre parcelave pasi që i njëjti është në shfrytëzim faktik për një kohë të gjatë nuk janë argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Sa i përket pretendimit se ka kontrata për shitblerje të pronave në fjalë, AKP-ja në kërkesën e pranuar nga parashtruesi i kërkesës nuk ka parë ndonjë kontratë të tillë e cila do të ishte subjekt i shqyrtimit, dhe se ngastrat të cilat janë objekt kërkesë janë të evidentuara në emër të NSH-së.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Nr. Ref. BD-220/61

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale:

- Parcela kadastrale P-71813046-00806-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3675 m²
 - Parcela kadastrale P-71813046-00807-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2140 m²
 - Parcela kadastrale P-71813046-00808-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2260 m²
 - Parcela kadastrale P-71813046-00808-2 me sipërfaqe të përgjithshme prej 2060 m²
- ZK Lubizhdë, komuna Prizren, të gjitha me sipërfaqe të përgjithshme prej 10135 m²,

pronë e KBI Progres NSh Lavertaria, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres NSh Lavertaria, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, këto ngastra kadastrale është duke i shfrytëzuar vite me radhë ndërsa në ndërkohë i njëjti ka lidhë kontrate qiraje me AKP-në.

Në këto parcela aktualisht nuk ka ndërtim dhe prona ka qasje të pa penguar në rrugë. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e këtyre parcelave me qëllim të zhvillimit të aktivitetit të tij me blegtori, si dhe marrëdhënia kontraktuale e qirasë me AKP-në nuk janë argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.






AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/62

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 2900 m² pjesë e parcelës kadastrale P-71813046-001270-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3674 m², ZK Lubizhdë, komunë Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres - Lavertaria, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres NSh Lavertaria, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se sipas deklaratës së parashtruesit të kërkesës, këtë ngastër kadastrale është duke e shfrytëzuar gjatë, ndërsa nuk ka cekur nëse ka ndërtim apo ndonjë specifikë e cila do të duhej të merrej parasysh për ta trajtuar kërkesën, ndërsa në ekspertizë theksohet se nuk ka ndërtim dhe se e njëjta hapësirë përdoret si parking. Parcela është në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore dhe aktualisht nuk ka ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë. Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e kësaj parcele në bazë të shfrytëzimit faktik për një kohë të gjatë, nuk paraqet argument se janë plotësuar kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.


AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/63

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00111-0 me sipërfaqe të përgjithshme 14352 m², ZK Petrovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se i njëjti me date 29.12.2019 ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale mbi shitblerjen e kësaj paligjshmërie me shitësin Shtësi dhe blerësi me kontratën në fjalë janë dakorduar që të bëhet shitblerja e ngastrës 111-0 në ZK Petrovë. Pas kësaj parashtruesi i kërkesës (sipas deklaramit të tij) ka bërë kërkesë në Komunën e Prizrenit në drejtorin e Kadastrit për bartje të pronësisë. Sipas kërkesës komuna ka nxjerrë aktvendim ku ka aprovuar kërkesën e palës dhe njëkohësisht është bërë bartja e pronës tek AKP ka iniciuar procedurë gjyqësore për të mbrojtur të drejtën mbi pronën dhe ka denoncuar shitësin në procedurë penale dhe i njëjti është shpallur fajtor për lidhje të kontratës dhe falsifikim të dokumenteve. Pretendimi i palës se këtë ngastër e ka blerë nga një person tjetër nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Në parcel nuk ka ndërtim dhe se e njëjta ka qasje direkte në rrugë. Për më tepër lidhur me transaksionin e realizuar organet e drejtësisë e kanë dënuar për falsifikim dokumentesh shitësin e ngastrës i cili ka bërë falsifikimin e dokumenteve mbi pronësinë e ngastrës se NSh.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/64

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 5725 m² pjesë e parcelës kadastrale P. Nr. 00464-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1169701 m², ZK Serbicë e Epërme, komuna Prizren, pronë/bashkëpronësi e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, Prizren dhe me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres Prizren dhe me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se është pronar i ngastrave 464-11, 464-10 dhe 464-9 dhe se pjesën e ngastrës 464-1 ne sipërfaqe prej 5725m² e shfrytëzon pasi që e njëjta ndodhet në anën lindore të parcelave të tij dhe se të njëjtën e përdorë për qasje në rrugë publike. Tutje parashtruesi i kërkesës ka deklaruar se ngastra ne fjalë është në bashkëpronësi mirëpo ai ka kërkuar që nga pjesa e NSH-së të bëjë blerjen përmes negociimit. Në këtë pjesë të parcelës së kërkuar nga pala aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë publike. Pretendimi i palës se është shfrytëzues i parcelës dhe është pronar i ngastrave 464-11, 464-10 dhe 464-9 dhe se pjesën e ngastrës 464-1 ne sipërfaqe prej 5725m² e shfrytëzon për qasje në rrugë publike nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

Në parcel nuk ka ndërtim dhe se e njëjta ka qasje direkte në rrugë. Po ashtu një element tjetër i rëndësishëm është fakti se kërkesa po ashtu është në kundërshtim me paragrafin 1.5 të nenit 4 të rregullores për shitje direkte për faktin se ngastra 464-1 është në Bashkëpronësi në mes të Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, Prizren dhe dhe se e drejta për të blere sipas rregullores në fjalë i bie bashkëpronarit dhe jo palëve tjera.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/65

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 2934 m² pjesë e parcelës kadastrale P. Nr.634-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 165674.4 m² dhe të sipërfaqes tokësore prej 2061 m² pjesë e parcelës kadastrale Nr.635-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 32071 m², ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin.
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se këto prona i ka në shfrytëzim së bashku me anëtarët e familjes qysh nga viti 2000 dhe të njejtat i ka në shfrytëzim edhe tani për nevoja bujqësore. Në pronë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe prona ka qasje të pa penguar në rrugë publike. Këtë faktë e ka deklaruar edhe vetë pala në kërkesën e tij për blerje direkte. Pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues e parcelave nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.


AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/66

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr. 00348-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 20410 m² ZK Trepënicë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, , me parashtrues _____ dhe të tjerët.
- II. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.05042-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 13872 m², ZK Prizren, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtrues _____
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres me parashtrues _____

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se parashtruesi i kërkesës dhe të tjerët, kanë deklaruar se ngastrat kadastrale 00348-0 dhe 05042-0 të përshkruara si me lartë, kanë qenë pronë e familjes _____ por se pas vitit 1965 ngastrat janë tjetërsuar nga ana e regjimit të atëhershëm. Ngastrat kadastrale të cilat janë objekt i kërkesës për blerje direkte nga pala aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit në ngastrën 348-0 ZK Trepënicë nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje në rrugë ashtu sikurse është prezantuar në ekspertizën gjeodezike të dorëzuar nga pala. Po ashtu, edhe ngastra 5042-0 ZK Prizren ka qasje në rrugë publike, dhe nuk ka ndërtim përveç se disa mureve të mbetura të një objekti të vjetër. Pretendimi i palës se ngastrat kadastrale 00348-0 dhe 05042-0, kanë qenë pronë e familjes _____ por se pas vitit 1965 ngastrat janë tjetërsuar nga ana e regjimit të atëhershëm nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rasti nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/67

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00380-3 me sipërfaqe të përgjithshme 1688 m², ZK Petrovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se parashtruesi i kërkesës, ka deklaruar se i njëjti është në fqinjësi me këtë ngastër dhe të njëjtën e shfrytëzon prej shumë viteve para periudhës së luftës. Pretendimi i palës se është shfrytëzues i parcelës dhe në fqinjësi me të nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Po ashtu në parcel nuk ka ndertim dhe se e njëjta ka qasje direkte në rrugë.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/68

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 471 m² pjesë e parcelës kadastrale Nr.00807-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 866 m², ZK Dragash, komuna Dragash, pronë e OPBB "Sharrprodhimi, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore OPBB "Sharrprodhimi, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se parashtruesi i kërkesës, ka deklaruar se është në fqinjësi me ngastren objekt i kërkesës dhe ka shumë pengesa për qarkullim. Tutje, pala ka theksuar se objekti (i NSh-së në ngastër) i dëmtuar dhe pa mirëmbajtje i pengon aq shumë pasi që në të strehohen qenë endacak dhe kjo është pengës për familjen e cila jeton në fqinjësi me këtë ngastër. Në këtë pjesë të parcelës së kërkuar nga pala aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ekziston një objekte i NSh-së nga metali i cili ka shërbyer si depo. Pretendimi i palës se është në fqinjësi me ngastrën 807-0 nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Po ashtu në këtë ngastër është objekti i NSh-së, një element tjetër i cili përjashton mundësinë e shitjes direkte në këtë rast dhe se ngastra po ashtu ka qasje direkte në rrugë. AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/69

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00988-39 me sipërfaqe të përgjithshme 10731 m², ZK Landovicë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se i njëjti është në posedim- shfrytëzues i ngastrës në fjalë të cilën e shfrytëzon për bujqësi. Tutje i njëjti deklaroi se posedon biznes (zdrukthëtar) të cilin planifikon ta zgjerojë dhe rrjedhimisht kërkon që këtë ngastër ta blejë përmes shitjes direkte. Pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues i parcelës dhe se dëshiron ta zgjerojë biznesin e tij nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Po ashtu në parcelë nuk ka ndertim dhe se e njëjta ka qasje direkte në rrugë.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/70

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale 00972-3 me sipërfaqe të përgjithshme 1484 m², ZK Lubizhdë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se është pronar i ngastrës 988-6 në ZK Lubizhdë e cila ngastër ka qenë e bashkuar me 972-3, mirëpo me qenë se disa familjarë të tij kishin shitur pjesë e tyre dhe kishin kërkuar që të bëhej ndarja fizike. Ndarja fizike është bërë dhe në shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës kanë mbetur ngastra 988-6 dhe 988-3 të cilat prona shfrytëzohet për me shumë se 50 vite sipas tij.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizen gjeodezike e cila e përshkruan dhe elaboron çështjen e ngastrës 988-4 dhe jo për ngastrën 00972-3 ZK Lubizhdë e cila është objekt i kërkesës së dorëzuar nga pala. Mirëpo, që të dy këto ngastra janë të ngjitura me njëra tjetrën dhe të cilat janë pa ndërtim dhe me qasje në rrugën e rregulluar sipas planit rregullativ.

Pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues i parcelës dhe se është pronar i ngastrës 988-6 në ZK Lubizhdë e cila ngastër ka qenë e bashkuar me 972-3, mirëpo me qenë se disa familjarë të tij kishin shitur pjesë e tyre dhe kishin kërkuar që të bëhej ndarja fizike nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/71

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr. 00378-0 me sipërfaqe të përgjithshme 5836 m², ZK Lubizhdë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin _____
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin _____

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se këtë ngastër kadastrale e shfrytëzon nga viti 1993-1994 për nevoja të biznesit të tij në të cilin ka ndërtuar një objekt në fillim të vitit 2020 me sipërfaqe 132m² të cilin e shfrytëzon për prodhim të plastikës dhe i ndihmon si objekt asistues në objektin tjetër të cilin e ka të ndërtuar në ngastrën e tij private 372-0 e cila është në kufi me ngastrën e cila është objekt i kërkesës. Sipas ekspertizës gjeodezike kjo ngastër shfrytëzohet nga _____ nga Prizreni dhe ka të ndërtuar një objekt P+0 me sipërfaqe prej 132m² dhe se ngastra 378-0 ZK Lubizhdë në pronësi të KBI Progres kufizohet me: Veri – ngastrën 379-0 me pronar _____ Perëndim – ngastrën 377-0 me pronar KBI Progres; Jug perëndim – me ngastrën 373-0 me pronar KBI Progres Jug – me ngastrën 372-0 me pronar _____ (parashtruesi i kërkesës); Lindje – Rrugë e cila është pa dalje. Pavarësisht faktit që në ekspertizën gjeodezike dhe fotot të saj ku shihet një objekt i ndërtuar për nevoja të biznesit ashtu sikurse është theksuar në këtë ngastër kadastrale i njëjti në pamje të gjeoportalit nuk shihet që ka ndonjë ndërtim dhe po ashtu kjo ngastër ka qasje në rrugë (pa dalje) ashtu sikurse është prezentuar në ekspertizën gjeodezike të dorëzuar nga pala.

Lidhur me faktin që ndërtimi i prezantuar në ekspertizën gjeodezike dhe fotove të saj i cili nuk shihet në pamjet e gjeoportalit të vitit 2018, duhet potencuar nenin 4 paragrafi 1.1.2 i Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve i cili ndër të tjera thekson se: *Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik, nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte.*

Pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e kësaj ngastre kadastrale pasi të njëjtën e shfrytëzon nga viti 1993-1994 për nevoja të biznesit të tij nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.



Përderisa sa i përket objektit i cili është aktualisht në këtë pjesë të ngastrës kadastrale i njëjti nuk shihet në pamjet e gjeoportalit të vitit 2018 dhe sipas deklaramit të palës i njëjti është ndërtuar në vitin 2020 e që sipas Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të NSh-ve nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte. Gjithashtu një element i cili duhet përmendur është edhe fakti se parashtruesi i kërkesës është në fqinjësi me ngastrën 378-0, dhe se objektin e ndërtuar në ngastrën e NSh-së ka mund ta ndërtojë në ngastrën e tij private e cila ka hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e një objekti të tillë dhe jo në ngastrën e NSh-së. AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/72

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 6303 m², pjesë e parcelës kadastrale P. Nr.00185-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 17584 m², ZK Petrovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se pjesën e ngastrës kadastrale e shfrytëzon si parking për makinerinë e tij dhe se ka ndërtuar një objekt pasi që kjo pjesë e ngastrës është në kufi me ngastrën e tij private. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij se bashku me një deklaratë të personit fizik

nga fshati Petrovë i cili ka deklaruar se është pronar i ngastrës 186-1 ZK Petrovë (fqinje me ngastrën 185-0) dhe se nuk ka pretendime dhe nuk do të pengojë blerjen e kësaj pjese të parcelës nga parashtruesi i kërkesës. Aktualisht në gjeoportali ngastra e cila është objekt i kërkesës ka numër 183-0 dhe jo 185-0 ashtu sikurse ka qenë në momentin kur është parashtruar kërkesa për negocim në AKP.

Pavarësisht faktit që në ekspertizën gjeodezike dhe fotot të saj shihet një objekt i ndërtuar për nevoja të biznesit, në këtë ngastër kadastrale në pamje të gjeoportalit nuk shihet që ka ndonjë ndërtim dhe po ashtu kjo ngastër ka qasje në rrugë publike ashtu sikurse është prezentuar në ekspertizën gjeodezike të dorëzuar nga pala. Lidhur me faktin që ndërtimi i prezantuar në ekspertizën gjeodezike dhe fotove të saj i cili nuk shihet në pamjet e gjeoportalit të vitit 2018, duhet potencuar nenin 4 paragrafi 1.1.2 i Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve i cili ndër të tjera parasheh se: *Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik, nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte.*

Po ashtu pretendimi i palës se i njëjti ka shprehur gatishmërinë për blerjen e kësaj ngastre kadastrale pasi e shfrytëzon për nevoja të biznesit si parking për makinerinë e tij dhe nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast.

MH



Përderisa sa i përket objektit i cili është aktualisht në këtë pjesë të ngastrës kadastrale i njëjti nuk shihet në pamjet e gjeoportalit të vitit 2018 e që sipas Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të NSh-ve nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte. Gjithashtu një element i cili duhet përmendur është edhe faktin se parashtruesi i kërkesës është në fqinjësi me ngastrën 185-0, dhe se objektin e ndërtuar në ngastrën e NSh-së ka mund ta ndërtojë në ngastrën e tij private jo në ngastrën e NSh-së.

Po ashtu kjo ngastrë është edhe nën komasacion.

AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.

Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



pNr. Ref. BD-220/73

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00719-11 me sipërfaqe të përgjithshme prej 321 m², ZK Lubizhdë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala ka deklaruar se është në fqinjësi me këtë ngastër dhe të njëjtën e shfrytëzon që nga viti 2000 se bashku me anëtarët e familjes së tij dhe i njëjti edhe sot është mbajtur i vetëdijshëm i kësaj palujtshmërie të cilën e shfrytëzon si tokë bujqësore. Pretendimi i palës se i njëjti është shfrytëzues i parcelës 719-11 nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Në parcelë nuk ka ndërtim dhe se e njëjta ka qasje në rrugën e rregulluar sipas planit rregullativ. AKP-ja, ka analizuar të gjitha shkresat dhe është bërë vlerësimi ligjor i rastit nga çka është konstatuar se kërkesa nuk bie në asnjë nga kategoritë për shitjen direkte sipas Rregullores 04/2024.


Duke u bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/74

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 01330-0, sipërfaqja e përgjithshme 27729 m² dhe parcelës kadastrale nr. 01329-0, sipërfaqja e përgjithshme 385 m² ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, prona të Ndërmarrjes Shoqërore Agromorava në Viti, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava në Viti, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij me qëllim ashtu sikurse ka deklaruar për rregullimin e Parkut të Stubllës dhe parking për vetura. Në kërkesë nuk është dhënë asnjë arsyetim apo përshkrim tjetër lidhur me këtë pretendim.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për t'i elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç se ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra.

Parcelat që janë objekt i kërkesës gjenden në ZK Stubëll e Epërme Viti dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe të njëjtat kanë në sipërfaqe të madhe prej 2.7 Ha e cila gjendet pothuajse në mesin e fshatit Stubëll.

Në këto të parcala sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit e njëjta ka qasje nëpër rrugë, në fakt rruga e emëruar Anton Qeta kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim të parashtruesit të kërkesës.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se dëshiron ta rregulloj parkut e fshatit – poashtu duhet pas parasysh fakti që parcala ka qasje në rrugë publike, ka ndërtime por nuk janë të palës dhe parcala ka hapësirë të madhe prej 2.7Ha. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025





Mentor Hyseni

Kryesues

Bordit Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/75

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1316 m² pjesë e parcelës kadastrale P. Nr.00185-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 17584 m², ZK Petrovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij pjesën e sipër cekur të ngastrës kadastrale e shfrytëzon qysh prej vitit 2000 së bashku me anëtarët e tjerë të familjes së tij të cilën e shfrytëzon si tokë bujqësore.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij. Tutje në këtë ekspertizë është theksuar se parashtruesi i kërkesës është pronar i ngastrës 423-0 ZK Petrovë e cila është në kufi me ngastrën si objekt kërkesë dhe të njëjtën e shfrytëzon pa penguar nga askush. Pala ka deklaruar në ekspertizë se këtë pjesë ka filluar ta rrethoj me murr betoni dhe një objekt prej bllokave të betonit si dhe në këtë pjesë ka pasur mjetet e tij të punës së biznesit të tij që zhvillon në këtë hapësirë.

Sipas të dhënave të prezantuara në ekspertizën gjeodezike dhe të cilat janë marrë nga ZKK në Prizren parcela 185-0 ZK Petrovë Prizren evidentohet si parcelë tokësore e klasit të pestë me kulturë arë dhe atë në emër të KBI Progres, Prizren. Në gjeoportali ngastra e cila është objekt i kërkesës ka numër 183-0 dhe jo 185-0 ashtu sikurse ka qenë në momentin kur është parashtruar kërkesa për negociim në AKP. Parcela ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore.

Pavarësisht faktit që në ekspertizën gjeodezike pala ka theksuar se ka ndërtuar një objekt në këtë ngastër kadastrale i njëjti në pamje të gjeoportalit nuk shihet që ka ndonjë ndërtim dhe po ashtu kjo ngastër ka qasje në rrugë publike ashtu sikurse shihet në gjeoportali.

Lidhur me faktin që ndërtimi i prezantuar në ekspertizën gjeodezike dhe fotove të saj i cili nuk shihet në pamjet e gjeoportalit të vitit 2018, duhet potencuar nenin 4 paragrafi 1.1.2 i Rregullores nr.04/2024 për shitjen direkte të asetëve të caktuara të NSh-ve i cili nder të tjera thekson se: *...Ndërtimet e realizuara, të cilat nuk janë të dukshme në aero incizimet e vitit 2018, kur në territorin e Republikës së Kosovës është zbatuar incizimi i fundit aerofotogrametrik, nuk do të përfshihen në proces të shitjes direkte.*



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin pasi e shfrytëzon qysh prej vitit 2000 se bashku me anëtarët e tjerë të familjes se tij të cilën e shfrytëzon si toke bujqësore – po ashtu duhet pas parasysh fakti që parcela ka qasje në rrugë publike. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
X Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/76

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1360 m2 pjesë e parcelës kadastrale P. Nr.00880-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 31321.3 m2 , ZK Llapllasellë, komuna Graçanicë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export – Ratar, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që këtë pjesë të ngastrës kadastrale 880-1 ta privatizoj përmes shitjes direkte. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur ortofoto dhe skica duke precizuar dhe përshkruar pretendimin e tij lidhur me ngastrën në fjalë.

Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Llapllasellë Graçanicë, pjesë në cilën ka ndërtime të shtëpive rezidenciale. Në këtë ngastrë kadastrale sipas pamjeve të gjeoportalit në disa pjesë të saj ka ndërtime mirëpo jo edhe në pjesën prej 1360m2 ku është e kufizuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës. Po ashtu e ngastra në fjale ka qasje të pa penguar në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin është shfrytëzues – poashtu duhet pas parasysh fakti që parcela ka qasje në rrugë publike. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.


Menton Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/77

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.0613-0, sipërfaqja e përgjithshme 1785 m² dhe parcelës kadastrale P. Nr.0615-0, sipërfaqja e përgjithshme 20951.5 m², ZK Lepi, komuna Graçanicë, prona të Ndërmarrjes Shoqërore Fabrika e Konfeksionit "Branka Demic" Knjazevac, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM


Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Fabrika e Konfeksionit "Branka Demic" Knjazevac, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij ka theksuar se është pronar i një biznesi serioz për prodhimin dhe përpunimin e drurit me një numër prej 70 të punësuarve. Pala ka theksuar se aktualisht aktivitetin e biznesit e ushtron në një objekt me qira dhe për qëllimet të zhvillimit të mëtejme të biznesit dhe punësimit është e domosdoshme një hapësirë me e madhe tokësore sikurse është specifikuar në kërkesë dhe rrjedhimisht parcelat e identifikuar si në kërkesë sipas tij i përgjigjen shumë mirë nevojave të biznesit të tij prandaj edhe ka parashtruar kërkesë për blerjen direkte të tyre.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke elaboruar pretendimet e tij. Në këtë ekspertizë është theksuar se pas matjeve në teren dhe krahasimit me të dhënat nga RDPP kemi një mospërputhje mes të dhënave tekstuale dhe grafike. Parcelat 0613-0, 0614-0, 0615-0, 0616-0, 0617-0, 0618-0, 0619-0, 9010-0 janë vetëm në pjesën grafike dhe jo tekstuale. Sipërfaqja e parcelave në pjesën grafike është 22736 m², kurse në pjesën tekstuale me të dhëna të vitit 2013 të njëjtat nuk ekzistojnë në pjesën tekstuale ndodhen vetëm parcelat 615-0 me sipërfaqe 20788 m² me pronar Fabrika e Konfeksionit "Branka Demic" Knjazevac.

Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në zonën kadastrale Lepi - Komuna e Graçanicë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këtë parcelë aktualisht sipas ekspertizës gjeodezike dhe pamjeve të gjeoportalit ka disa ndërtesa të vjetra të ndërmarrjes të cilat janë të demoluara dhe jashtë përdorimit, e njëjta do të ketë qasje të pa penguar në rrugë publike.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte me arsyetimin se kërkon blerjen e parcelës me qëllim të zhvillimit të mëtejme të biznesit dhe punësimit dhe nevojës për një hapësirë më të madhe për biznesin e tij. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrijë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/78

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00158-1 me sipërfaqe të përgjithshme 9053 m², ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.


Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij se parcelën në fjalë e ka në shfrytëzim ai dhe familja e tij që nga viti 2000 të cilën e shfrytëzojnë si toke bujqësore. I njëjti ka deklaruar se këtë ngastër e ka blerë nga ish pronari nga Prizreni.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike për të elaboruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën në fjalë. Vetëm Certifikatat pronësore lidhur me ngastrën, Kontratën e shitblerjes mes tij dhe personit fizik si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit lidhur me vërtetimin padisë se NSh ku konfirmohet pronësia e NSh si dhe Aktakuzën e Prokurorisë Themelore të Prizrenit ndaj palës i lidhur me falsifikime të dokumenteve.

Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Dushanovë Prizren dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë ngastër kadastrale sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë fushore.

Parashtruesi i kërkesës, ka deklaruar se i njëjti me datë 18.03.2010 ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale mbi shitblerjen e kësaj patundshmërie me shitësin Shitësi dhe blerësi me kontratën në fjalë janë dakorduar që të bëhet shitblerja e ngastrës 00158-1 në vendin e quajtur "rakita-do puta" me sipërfaqe të përgjithshme prej 9053 m² ZK Dushanovë.

Pretendimi i palës se i njëjti ngastra kadastrale 619-0 është në mesin e dy parcelave të tij private të cilat i ka privatizuar në valën 53 të shitjes nuk është argument i cili plotëson kriteret e Rregullores për shitje direkte për të iniciuar procedurën e shitjes direkte lidhur me këtë rast. Në parcelë nuk ka ndërtim dhe se e njëjta ka qasje në rrugën.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Për me tepër lidhur me transaksionin e realizuar organet e ndjekjes janë duke ndjekur sipas aktakuzës për falsifikim dokumentesh shitësin e ngastrës i cili ka bërë falsifikimin e dokumenteve mbi pronësinë e ngastrës se NSh.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/79

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00619-0 me sipërfaqe të përgjithshme 2664 m², ZK Lubizhdë, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se në deklaratën e tij se parcela kadastrale 619-0 është në mesin e dy parcelave të tij private të cilat i ka privatizuar në valën 53 të shitjes nga Agjencia. Tutje pala ka theksuar se lidhur me këtë parcelë cila është objekt i kërkesës nuk e din arsyen pse nuk është listuar në listën e parcelave për shitje në valën kur i ka privatizuar edhe ngastrat tjera, dhe si rrjedhojë kërkon që të njëjtën ta privatizojë. Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke i elaboruar pretendimet e ti lidhur me ngastrën në fjalë.

Sipas ekspertizës gjeodezike, ngastra kadastrale 619-0ZK Lubizhdë në veri kufizohet me ngastrën 614-0 e cila shfrytëzohet si rrugë në pronësi të PSh Rrugët, në jug dhe juglindje me ngastrën 622-3 në pronësi të _____, në perëndim me ngastrën 620-0 në _____ në Lindje me ngastrën 617-0 në pronësi të Florim _____emaj. Parcela ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore.

Në këtë parcelë sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë, ashtu sikurse është theksuar edhe në ekspertizën gjeodezike të dorëzuar nga pala.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se parcela gjendet mes dy parcelave të tij private – po ashtu duhet pas parasysh se në parcelë nuk ka ndërtim dhe ka qasje të papenguar në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025




Mentor Hyseni

Kryesues

Bordit Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/80

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P-70403013-01651-1 me sipërfaqe të përgjithshme 6793 m², ZK Gjilan, komuna Gjilan, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Agro-kultura, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agro-kultura, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet fillestare e ka dorëzuar në Agjenci së bashku me të gjitha dokumentet e parashtruara dhe e njëjta ishte tërësisht e palexueshme – e pa kuptueshme. Nuk është mjaftueshëm e qartë se për cilat parcela kadastrale saktë kërkohet, provat e bashkangjitura datojnë prej shumë kohë më parë të cilat nuk korrespondojnë me gjendjen aktuale, qoftë atë kadastrale qoftë vendimet përfundimtare lidhur me statusin e pronave. Pala ka ofruar si dëshmi vetëm disa prova të cilat mund të cilësohen se shkojnë në favor të tij, duke mos paraqitur vendimet apo aktgjykimet të cilat përfundimisht kanë qenë në favor të NSh-së.

Agjencia me dt. 29 maj 2024, me një shkresë të veçantë ka kërkuar nga pala plotësimin e kërkesës dhe precizimin e pretendimit si dhe dorëzimin e elaboratit kadastral. Pala e ka pranuar shkresën e AKP-së, dhe me dt.13.06.2024, pala e ka ripërsëritur kërkesën e cila pothuajse është identike me kërkesën themelore. Nuk ka ofruar informata plotësuese, përsëri nuk e ka dorëzuar elaboratin kadastrale për parcelat për të cilat pretendon e as aktgjykimet me të cilat pala ishte njoftuar për statusin përfundimtar të procesit gjyqësor.

Nga analizimi i shkresave të lëndës, kuptohet se pretendimet e parashtruesit mbi bazën e kërkesës janë kryesisht për faktin se dikur kjo pronë ishte pronë private e cila ishte blerë nga personat privat dhe nuk ishte pronë e NSh-së. Megjithatë, nga vetë provat e paraqitura nga pala por edhe atyre të siguruara sipas detyrës zyrtare, konstatohet se NSh kishte ndërtuar objektet afariste për zhvillimin e veprimtarisë së saj qysh nga viti 1981. Puna dhe veprimtaria e NSh-së kishte qenë konstante dhe se në vazhdimësi, pa u penguar kurrë nga askush. Për më tepër, se NSh-ja ishte pronare ligjore e tokës u vërtetua edhe në procedurën gjyqësore me aktgjykim përfundimtar të iniciuar nga vet pala. Kjo procedurë gjyqësore e cila ka përfunduar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës me Aktgjykimin Ref.Nr. AC-II-12-0006, dt 08.12.2016, me të cilin vërtetohet se pronare e tokës kontestuese është Ndërmarrja Shoqërore “Agro-kultura” Gjilan.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.


Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit





Nr. Ref. BD-220/81

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.02001-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 13321 m² dhe parcelës kadastrale P. Nr.02002-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 4993 m². ZK Smirë, komuna Viti, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore Tefik Çanga, me parashtruesin
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Tefik Çanga, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes me negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në deklaratën e tij ku pretendon se është pronar faktik i ngastrave të cilat janë objekt i kërkesës. Sipas palës ai dhe familja e tij këto ngastra i shfrytëzojnë për me tepër se 100 vite kur edhe të paret e tyre i kane shfrytëzuar pa kurrfarë problemi dhe pengesë prej askujt. Tutje pala deklaroi se nuk e di arsyen se pse këto ngastra kane mbetur si prona shoqërore, por se të njëjta dëshiron ti bartë në pronësi të tij.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar pretendimet e tij, përveç se një autorizim dhe një certifikatë pronësore të kësaj ngastre kadastrale.

Ngastrat të cilat janë objekt i kërkesës gjenden në ZK Smirë - Viti dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë ngastër sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe të njëjtat ka qasje në rrugë malore por publike të quajtur Malsori.

Pretendimi i palës se ai dhe familja e tij këto ngastra i shfrytëzojnë për me tepër se 100 vite kur edhe të paret e tyre i kane shfrytëzuar pa kurrfarë problemi dhe pengesë prej askujt


Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte sepse pala pretendon që së bashku me familje këtë ngastër e shfrytëzojnë mbi 100 vite pa u penguar nga askush, po ashtu në ngastra nuk ka ndërtim dhe të njëjtat kanë qasje në rrugë malore publike.

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrorë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.





Nr. Ref. BD-220/82

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelave kadastrale:

- P. Nr.01997-11 me sipërfaqe të përgjithshme prej 900 m²
- P. Nr.01997-10 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1606 m²

ZK Rahovec, komuna Rahovec, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore NBI Rahovec, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NBI Rahovec, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes së negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm duke prezantuar disa ortofoto me certifikata pronësore të këtyre ngastrave se bashku me disa fotografi dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim apo arsye mbi të cilin do ta bazonte kërkesën e tij për blerjen e këtyre ngastrave. Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur as ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar pretendimet e tij.

Ne anën tjetër duke u bazuar në dokumentet e prezantuara nga pala si dhe konfirmimi nga ZR Prizren AKP ngastra kadastrale 1318-1 ZK Rahovec nuk është pronë e NSh NBI Rahoveci, por e Komunës Rahovec. Përderisa në anën tjetër, sa i përket parcelave 1997-10 dhe 1997-11 ZK Rahovec të cilat janë të NSh NBI Rahovec, për të njëjtat në vitin 2013 Komuna e Rahovecit ju është drejtuar AKP-se me kërkesë për ti marrë këtë ngastër për realizimin e projektit për ndërtimin e shtëpisë së pleqve.

Ngastrat 1997-10 dhe 1997-11 të cilat janë objekt i kërkesës gjendet në ZK Rahovec në Komunën e Rahovecit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme. Në këto ngastra sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe të njëjta kanë qasje të pa penguar në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte sepse në ngastër nuk ka ndërtim dhe të njëjta kanë qasje të pa penguar në rrugë publike. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


MAH



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.



Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/83

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.06672-0 me sipërfaqe të përgjithshme 2747 m². ZK Prizren, komuna Prizren, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negociim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij ngastrën e shfrytëzon qysh para vitit 1970 dhe se e njëjta ende është në shfrytëzim faktik të tij dhe familjes së tij.

Pala në mbështetje të kërkesës ka bashkangjitur edhe ekspertizën gjeodezike duke i elaboruar pretendimet e tij lidhur me ngastrën në fjalë, si dhe disa kontrata të qirasë në mes parashtruesit të kërkesës dhe NSh-së si dhe disa fletëpagesa të qirasë. Sipas përshkrimit të dhënë në skicën e parcelës e njëjta është e rrethuar me prona private të personave të ndryshëm.

Ngastra e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Prizren dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë ngastër sipas pamjeve të gjeoportalit dhe ortofotos së prezantuar nga parashtruesi i kërkesës nuk ka ndonjë ndërtim.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte vetëm për arsyen se është shfrytëzues i parcelës— e cila nuk ka ndërtim.


Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025





Nr. Ref. BD-220/84

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.00030-0 me sipërfaqe të përgjithshme 6281.4 m², ZK Petrovë, komuna Prizren pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Progres, me parashtruesin

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij i njëjti dhe familja e tij janë shfrytëzues faktik i kësaj ngastre qysh nga viti 1991 dhe së bashku me familjen e shfrytëzojnë në mënyrë të papenguar nga askush. Pala po ashtu ka deklaruar se e njëjta ka mundur të pësojë ndryshime duke u ndërtuar objekte të ndryshme, megjithatë e njëjta është ruajtur duke e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore-livadh.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar pretendimet e tij, përveç se një ortofoto dhe një certifikatë pronësore të kësaj parcele.


Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Petrovë Prizren dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë ngastër kadastrale sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndonjë ndërtim dhe e njëjta ka qasje të pa penguar në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte vetëm për arsyen se është shfrytëzues i parcelës— e cila ka qasje në rrugë dhe nuk ka ndërtim. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



Tel: +383 (0) 38 500 400

Faks: +383 (0) 38 248 076

Email: info@pak-ks.org

www.pak-ks.org

Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës



Nr. Ref. BD-220/85

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale P. Nr.01014-0 me sipërfaqe të përgjithshme 2098 m², ZK Hajvali, komuna Prishtinë, pronë e Ndërmarrjes Shoqërore KBI Kosova Export - Ratar, me parashtruesin .
- II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për iniciim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export - Ratar, me parashtruesin .

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për iniciim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se duke qenë se pala kërkesën e vet e ka bazuar vetëm në faktin se sipas deklaratës së tij i njëjti është pronar i parcelave 01016-3 dhe 01015-0 të cilat kufizohen me ngastrën 01014-0 e cila është objekt i kërkesës. Sipas tij ngastra 01014-0 para viteve 1990 ka qenë në tërësi diku 2800m² pronë e (fqinjtit) ku para vitit 1990 e njëjta ka kaluar ne pronë shoqërore tek KBI Kosova Export por qe e njëjta nuk e shfrytëzuar apo punuar këtë ngastër. Pala ka deklaruar se qysh nga atëherë e ka në shfrytëzim të cilën e ka punuar dhe si rrjedhojë dëshiron të njëjtën të blej përmes shitjes direkte

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizë gjeodezike për të elaboruar pretendimet e tij, përveç se një ortofoto dhe një certifikatë pronësore së bashku me kopjen e planit të kësaj ngastre kadastrale.

Parcela e cila është objekt i kërkesës gjendet në ZK Hajvali - Prishtinë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme bujqësore. Në këtë ngastër kadastrale sipas pamjeve të gjeoportalit në pjesën dërmuese te saj nuk ka ndërtim, përveç se disa pjesë të ngastrave tjera private (01012-0; 01012-4 dhe 01012-5) të cilat një pjese të ndërtimit te tyre e prekin ngastrën e NSh-së 01014-0, përderisa ngastrat kadastrale 01016-3 dhe 01015-0 te cilat janë prona private te parashtruesit të kërkesës nuk kanë ndërtim të cilat ngërthejnë apo prekin ngastrën 01014-0. Parcela ka qasje te pa penguar në rrugë publike.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për iniciimin e procedurës për shitje direkte vetëm për arsyen se është shfrytëzues i parcelës dhe e ka në fqinjësi me parcelat e tij – e cila ka qasje në rrugë.




AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 14 mars 2025.





Mentor Hyseni

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/86

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet iniciimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 179 m², pjesë e parcelës kadastrale nr. 196-0, me sipërfaqe të përgjithshme 8319 m² dhe sipërfaqes prej 262 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 0197-0 me sipërfaqe të përgjithshme 1706 m², ZK Ferizaj, komuna Ferizaj, NSh Pasuria Bujqësore, me parashtruesen
- II. Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale, ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i iniciimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Pasuria Bujqësore, me parashtruesen

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritorë, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për iniciim të procedurës së shitjes së shijes me negociim direkt sipas nenit 7.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në paragrafi I në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrtojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 14 mars 2025.



X
Mentor Hyseni
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



Nr. Ref. BD-220/87

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 14 mars 2025 nxjerr këtë:

